

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	202/21
Nr. i fq. / Br. st.	- 3 -
Data: / Datum:	16.09.2021
VUSHTRRI - VUČITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUCITRN**

PROCESVERBAL

**në mbledhja e V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
15 korrik 2021 në sallën e kryetarit të komunës, e cila filloj në ora 14:20.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latif, Gresa Muli, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Abit Abiti zyrtar kryesor financiar, si dhe nga sekretaria e kuvendit Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjafueshme për punë.

Aliu tha se ka ardhur si pikë shtesë <Shqyrtimi i Raportit tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore>, e cila ka qenë e planifikuar me Planin e Punës së Kuvendit të Komunës.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11 qershor 2021;
 2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2021;
 3. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore;
 4. Të ndryshme.
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11 qershor 2021.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 11 qershor 2021.

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2021.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – theksoi se është një informatë e shkurtër, por mirë e përpiluar. Ai si shqetësim e paraqiti siguribnë në vende publike, gjegjësisht prezencën e numrit të madh të qenve endacakë, me të cilët ballafaqohen qytetarët komunës sonë, si në qytet ashtu edhe

në fshatra. E dimë që kemi një vend ku bëhet grumbullimi i qenve dhe trajtimi i tyre, por aty janë mundësítë e kufizuara, tha ai.

Prandaj, kishte me qenë mirë që si qeverisje lokale, si komunë të ndërmerren masa, pra të kemi një plan apo një projekt konkret, në mënyrë që mos të rrezikohen qytetarët. Unë ka qenë dëshmitar në një rast në Stanoc, se si qentë endacakë e kanë sulmuar një qytetare duke shkuar në punë, ku nga frika e qenve ka dalë në magjistrale, ku iu ka dalë veturave përpara dhe fatmirësisht ka shpëtuar pa pasoja.

Tek siguria në shkolla kemi një përparim, por duhet shtuar edhe më tutje prezenca e policëve nëpër shkolla, sidomos në shkollat e mesme të larta.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – pajtohem edhe unë se vërtet është shqetësim për qytetarët prezenca e qenve endacakë. Ai tha se një fqinj i imi, në banesën ku jetoj është kafshuar nga qentë endacakë dhe këto ditë është liruar nga spitali. Është një sfidë e krejt komunave të Kosovës, sepse ka shpenzime të mëdha buxhetore menaxhimi i qenve endacakë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se jemi në mesin e muajit korrik ku mbretërojnë temperatura të larta, kurse kemi mungesë të ujit të pijes në qytet dhe në shumë fshatra. Ai tha se qytetarët po kërkojnë që të ketë furnizim më të mirë të ujit të pijes. Gjendemi në një fazë, ku shumë ekonomi familjare janë kyçur në rrjetin e ujësjellësit, por ende nuk është bërë pranimi teknik i kryerjes së punëve dhe qytetarët janë të brengosur për shpenzimet që i bëjnë për ujë dhe nuk kanë faturë.

Ai pyeti se: Çka do të ndodhë me ekonomitë familjare, gjegjësisht me qytetarët që janë kyçur në rrjetin e ujësjellësit, por nuk e kanë bërë pagesën (prej 80 euro)? Si do të trajtohen këto ekonomi familjare?

Pra, kemi një dëm që mund t'iu bëhet ekonomive familjare në një masë të konsiderueshme, sepse shumica e qytetarëve e kanë kryer pagesën prej 80 euro për kyçje në rrjetin e ujësjellësit, por ka raste që janë kyçyr dhe nuk kanë bërë pagesë.

Kjo çështje lidhet me këtë pikë të rendit të ditës, sepse disa ekonomi familjare në mungesë të ujit të pijes, janë të detyruar të bëjnë zgjidhje, ku këtë zgjidhje e bëjnë në mbrëmje dhe bartin ujë me traktor dhe në shumicën e rasteve nuk kanë drita dhe rrezikojnë edhe veten e tyre duke bartur ujë me cisterna, por e rrezikojnë edhe sigurinë e të tjerëve në komunikacion.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Raportit tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

Abit Abiti, zyrtar kryesor financiar – kërkoi falje në emër të drejtorisë që këtë pikë nuk kanë mundur ta sjellin kur është dërguar materiali për KPF për shkak të volumit të punëve. Ky raport

paraqet shënimë mbi arkëtimet, shpenzimet dhe një përbledhje të shpenzimeve kapitale. Pra, kemi një analizë të shpenzimeve sipas kategorive.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **14:40**.

Bujar Klinaku
Pjetër Gjonç
Procesmbajtës

